



**Shkurt
2023**



**Advocacy Center
for Democratic Culture**

BULETINI

Në muajin shkurt, OJQ ACDC vazhdoi të organizojë ngjarje që trajtonin tema dhe probleme të rëndësishme të qytetarëve.



**Advocacy Center
for Democratic Culture**

Social networks



+381 (0) 64 11 77 871
+383 (0) 44 53 98 52
office@acdc-kosovo.org



Shkurt 20

Takimi Publik për shpronësimin

Vendimi i Qeverisë në Prishtinë për shpronësimin e tokës në pronësi të serbëve në komunën Leposaviq dhe Zubin Potok ishte çështja kryesore në veri të Kosovës në muajin shkurt.

Në lidhje me këtë, më 20 shkurt, OJQ ACDC organizoi takim publik me qëllim të tërheqjes së vëmendjes së bashkësisë ndërkombëtare dhe qeverisë së Kosovës për konfiskimin e paligjshëm të tokës nga serbët në veri të Kosovës.

SFolësit në këtë ngjarje ishin Zoran Todiq, ish-kryetari i komunës së Leposaviqit, Predrag Miljković, avokat nga Mitrovica e Veriut, Dushko Çeliq, profesor juridiku dhe ekspert për çështje pronësore dhe Mladen Çiprijanović, avokat nga Leposaviqi.

Takimi u organizua në kuadër të projektit “Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet me shumicë serbe në Kosovë”, i mbështetur nga INL.



Njoftim për medie

Në fillim të këtij muaji, OJQ ACDC, së bashku me organizata të tjera joqeveritare, kanë publikuar një deklaratë të përbashkët duke shprehur shqetësim dhe protestën e madhe për vendimet e Qeverisë së Kosovës për shpronësimin e tokës në veri të Kosovës.

Deklarata e përbashkët i bëri thirrje qeverisë në Prishtinë që të ndalojë të gjitha projektet në parcelat private dhe publike derisa të bëhen konsultime gjithëpërfshirëse me komunitetin lokal, përfaqësuesit lokal dhe shoqërinë civile.

SRB


ALB

ENG

Media Coverage



RADIO-TELEVIZIJA VOJVODINE





Shkurt 27

Diskutim publik

Në kuadër të projektit të mbështetur nga INL "Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet me shumicë serbe në Kosovë", u organizua diskutim publik në lidhje me punën në sektorin gjyqësor nga këndvështrimi i avokatëve.

Diskutimi dha disa njohuri kyçe për situatën në gjyqësorin në veri të Kosovës pas dorëheqjes së gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit tjetër administrativ dhe mbështetës nga institucionet gjyqësore.

Pjesëmarrës në këtë ngjarje ishin avokatët dhe përfaqësuesit ligjor të serbëve nga veriu i Kosovës, Nebojsa Vllajiq dhe Jovana Fillipoviq, si dhe drejtori ekzekutiv i OJQ ACDC, Dushan Radakoviq.



Vizita e ambasadorit austriak

Gjatë takimit, Drejtori Ekzekutiv i ACDC, Dushan Radakoviq, Drejtoresha Ekzekutive e Iniciativës së Re Sociale, Jovana Radosavljeviq, dhe kreu i Zyrës për Politika të OJQ Aktiv, Caleb Waugh, e njohën ambasadorin me situatën aktuale në veri të Kosovës nga perspektiva e komunitetit të serbëve.

Më 8 shkurt, Ambasadori i Austrisë në Kosovë, z. Christoph Weidinger dhe zëvendësi i tij, z. Martin Schaller, u takuan me përfaqësues të shoqërisë civile nga Mitrovica Veriore.

ACDC në Media

Aleksandar Rapajiq, drejtori i programit të ACDC, i'u bashkua diskutimit në emisionin televiziv "Dogovor" i cili u fokusua në themelimin e Asociacionit të Komunave Serbe. [LINK](#)



Zyrtarja e programit Ines Aljović Mihajlović foli për RTK 2 për hulumtimin që ACDC është duke realizuar për pozitën e grave shtatzëna dhe nënave të reja dhe të drejtat e tyre në punë.

Dushan Radakoviç në Kallxo Përnime, foli për krizën në veri dhe shpronësimin e tokës në Dren.



Dushan Radakoviç për Tanjug, foli për shpronësimin e tokës në veri.



Dushan Radakoviç për RTV Kim, foli për kthimin e policëve serb.



Dushan Radakoviç për Kosovo Online, deklaroi se si ka funksionuar gjyqësori i Kosovës në veri pas largimit të serbëve nga iniciativat



Dushan Radakoviç, drejtor ekzekutiv i OJQ ACDC, mori pjesë në Konferencën Vjetore të Grupit Punues të Konventës Kombëtare të Bashkimit Evropian për Kapitullin 35, të titulluar "Drejt Marrëveshjes". Ai gjatë panelit trajtoi disa tema të rëndësishme që nuk janë të përfshira në marrëveshje, siç janë çështjet pronësore.



Ditët ndërkombëtare

ACDC vazhdoi të shënojë ditët ndërkombëtare për të tërhequr vëmendjen e publikut për disa çështje thelbësore dhe për të përcjellë njohuri për ditët e rëndësishme ndërkombëtare.

“Duke afirmuar Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, ne theksojmë diversitetin gjuhësor. Duke e ushqyer atë, ne ruajmë traditat kulturore të njerëzve dhe zhvillojmë një kulturë dëgjimi, komunikimi dhe mendimi.”



“Besohet se festimi i kësaj dite kontribuon në fuqizimin e mëtejshëm të përpjekjeve të komunitetit ndërkombëtar për zhdukjen e varfërisë, rritjen e shqetësimit për dinjitetin e punës, mundësitë e barabarta dhe qasjen e drejtë në të mirat sociale dhe në drejtësi për çdo qenie njerëzore.”



“Në këtë ditë, e festojmë rolin e OSHC-ve në luftën për të drejtat themelore të njeriut, demokracinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm për të gjithë. Sot, ne e pranojmë guximin, veçantinë dhe qëndrueshmërinë e tyre në krijimin e një të nesërme më të mirë për të gjithë shoqërinë njerëzore.”



Ndihmë Juridike Falas

OJQ ACDC vazhdon të ofrojë shërbime të ndihmës juridike falas në mbështetje të Zyrës për Ndihmë Juridike Falas në veri të Kosovës.

OJQ ACDC fton të gjithë ata që kanë probleme në ushtrimin e të drejtave të tyre në Kosovë të vizitojnë zyrën tonë dhe të kontaktojnë bashkëpunëtorët juridik të cilët do t'u ofrojnë shërbime juridike, informata dhe këshilla falas.

Projekti i ri

OJQ ACDC ka kënaqësinë të njoftojë vazhdimin e projektit "Promovimi i dialogut ndëretnik në pushtetin lokal", financuar nga National Endowment for Democracy (NED). Projekti është krijuar për të fuqizuar komitetet e komuniteteve, për të promovuar marrëdhënie të mira ndëretnike në qeverisjen lokale në veri të Kosovës dhe për të mbështetur iniciativat e vogla lokale në Mitrovicën e Veriut dhe Zveçan.

Shihni disa nga iniciativat dhe aktivitetet që janë zbatuar në vitin paraprak.



Vizita studimore në Bujanoc



Menaxheri i programit, Sllobodan Stoshiq, së bashku me përfaqësues të tjerë të OJQ-ve nga veriu i Kosovës vizituan komunat e Bujanocit, Preshevës dhe Medvegjës. Qëllimi i vizitës studimore të organizuar nga OJQ Aktiv ishte shkëmbimi i përvojave në fushën e bashkëpunimit ndëretnik, marrëdhënieve me institucionet lokale dhe qendrore, si dhe respektimi i të drejtave të njeriut të komuniteteve joshumicë.